



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

VENDIM

Nr. 38, datë 31.01.2024

PËR

**SHPLLJEN E KËRKESËS PËR KANDIDATURA NGA RADHËT E
GJYQTARËVE PËR KOMANDIM NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR,
KOHËZGJATJEN, KRITERET DHE PROCEDURËN E KOMANDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79, shkronja “b”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenet 8, 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, me bashkëpropozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

I. Hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për 4 (katër) pozicione “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor 1(një) pozicion “Këshilltar” në Njësinë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme.
3. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është deri në datë 14.02.2024.
4. Kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:
 - a. Kërkesë me shkrim për shfaqjen e vullnetit për komandim për pozicionin e shpallur;
 - b. Jetëshkrimin, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit, përveç edhe të dhënat mbi historikun e arsimimit dhe rezultatet e tij;
 - c. Certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj;
 - d. 5 (pesë) dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës, etj.;

- e. Vetëdeklarim për mosdodhjen në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarin e Përgjithshëm ose gjyqtarët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- f. Rekomandime për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup;
- e. Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

II. Kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit

1. Kohëzgjatja e komandimit është 2 (dy) vjet me të drejtë ripërsëritje brenda afatit 5 (pesë) vjeçar.
2. Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit:
 - a. me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;
 - b. kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;
 - c. kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;
 - d. kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;
 - e. kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra;
 - f. për shkak të konfliktit të interesit që mund të gjendet gjatë ushtrimit të funksionit në pozicionin si magjistrat i komanduar.
3. Kriteret e komandimit janë:
 - a. Kandidati të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë si gjyqtar;
 - b. Komandimi të mos bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
 - c. Kandidati të mos jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
 - d. Kandidati të mos jetë i komanduar;
 - e. Kandidati që ka qenë i komanduar më parë, i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit dhe ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;
 - f. Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - g. Kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarin e Përgjithshëm ose gjyqtarët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.
4. Ka përparësi kandidati që plotëson këto kriteret:

Ka ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatorë dhe ka përvojë në administratë publike;

- a. Ka njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor;
 - b. Është autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës;
 - d. Ka njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;
 - e. Ka aftësi të shumë të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.
5. Për vlerësimin e kritereve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, në dokumentacionin e administruar nga Këshilli, në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit, si dhe në çdo dokument tjetër që mund të merret nga burimet e përcaktuara në nenin 77 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.
 6. Brenda dy javëve pas afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin apo kur për kandidatin verifikohet ndonjë prej kritereve të tjera ndaluese të komandimit.
 7. Procedura e komandimit vijon me vlerësimin e kritereve të përparësisë së kandidimit për të gjithë kandidatët që nuk janë përjashtuar nga kandidimi sipas pikës 6 të këtij Kreu. Ky vlerësim bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i cili, kur çmon të nevojshme, mund të intervistojë kandidatin. Intervista dokumentohet në një procesverbal me shkrim.
 8. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale brenda dy javëve i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor një raport ku pasqyrohen të dhënat rreth përmbushjes nga kandidatët të kritereve të kandidimit përfshirë edhe atyre preferenciale bashkë me renditjen e tyre, duke filluar nga kandidati i vlerësuar më mirë. Krahas kësaj, Komisioni i paraqet Këshillit dhe një propozim për komandim me emrin e kandidatit të renditur më lart.
 9. Brenda një jave nga paraqitja e raportit dhe propozimit për komandim, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor thërret mbledhjen plenare, për të vendosur në lidhje me komandimin e gjyqtarit kandidat në pozicionin e mësipërm.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos komandimin për kandidatin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Në rast të mosmiratimit të propozimit të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të propozojë komandimin e një gjyqtari tjetër kandidat që plotëson kriteret e komandimit. Ky propozim i nënshtrohet votimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

11. Nëse asnjë prej gjyqtarëve kandidatë nuk komandohet, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicioneve “Nëpunës përgjegjës për vlerësim” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve dhe “Këshilltar” në Njësinë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR